

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k**

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

**Znj. Nuriana Isufi**, e datelindjes 05.07.1987, e bija e Hysen-it, lindur ne Erseke, Kolonje dhe banuese ne Njësia Administrative Nr. 6, Rruga Fabrika e Qelqit; Nd. 76; H. 1; Kodi Postar 1027; Tiranë, identifikuar me leternjoftim nr.034213507 dhe nr personal I75705058J madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k**  
Sot me date **01.04.2021**, bazuar ne vullnetin e saj te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**Kreu I**  
**OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1**  
**Objekti i shoqerise**

Shoqeria Tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Kembim valutor. Transferte parash. Shitje e blerje çeqesh, monedha te metaleve fisnike. Ushtrim i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe llogari të nje subjekti financiar jo- bankë. Rimbushje dhe pagesa elektronike. Shitje me pakice te aksesoreve te ndryshem. Agjent i shoqerise EasyPay Sh.p.k. (Institucion i Parase Elektronike), per kryerjen e sherbimeve qe perfshijne po nuk kufizohen ne pagesa faturash, shitje te mallrave/sherbimeve te partnereve te EasyPay.

**Neni 2**  
**Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertojne “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Njësia Administrative Nr. 6, Rruga Thoma Koxhaj, Pallatet “Agolli”, Kati 1, Dyqani Nr.2, Kodi Postar 1027; Tiranë

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

**Neni 3**  
**Forma Juridike**

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakut mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortakut do ta pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.

3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4**

##### **Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut**

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

## **Kreu III**

### **KAPITALI THEMELTAR**

#### **Neni 6**

##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

##### **Ortaku i shoqerise eshte:**

1. **Nuriana Isufi**, zotëruese e 1(nje) kuote me vlere 100.000 leke, qe perfaqeson **100% (njqind %) kapitalin themeltar të shoqërisë;**

## **Kreu IV**

### **PERSONALITETI JURIDIK**

#### **Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

## **Kreu V**

### **ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Ergys Dervishi** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese) vjecare** dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

**Kreu VI**  
**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.  
Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.  
Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**Ortaku Themelues**

**Nuriana Isufi**

Nuriana Isufi

